



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

SHPLLJE PËR EKSPTERT LIGJOR

Në zbatim të Vendimit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit nr.287, datë 08.06.2026, *“Kontratktimi i një eksperti ligjor për për rishikimin e ligji nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM nr.187 datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendesministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar; Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me Vendimin nr.96, datë 12.02.2024 të Autoritetit për Informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) shpall shpall konkurimin e hapur për **1 vend vakant**, me kontratë, me kohë të kufizuar, në pozicionin:*

- Ekspertit Ligjor;
- Kohëzgjatja e kontratës, 15 ditë pune për një periudhë 60 ditë kalendarike;
- Kategoria e pages, III-1;

Afati për dorëzimin e dokumentave:

16.06.2026

1 SFONDI DHE KONTEKSTI:

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), në kuadër të përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rritjes së efektivitetit në ushtrimin e funksioneve të tij, ka nisur një proces të brendshëm rishikimi të ligjit nr. 45/2015. Ky proces bazohet në ndeshjen e boshllëqeve ligjore në ligjin aktual të lidhura kryesisht me dy elementë të shtuar me ndryshimet ligjore të vitit 2022 dhe që lidhen me qartësimin e fatit të personave të zhdukur dhe edukimin qytetar.

Për këtë qëllim, me Urdhërin nr. 144, date 20.05.2026, të Kryetares, është ngritur një Grup Pune i brendshëm, i përbërë nga drejtues të të gjitha drejtorive dhe i kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm me detyra kryesore:

- Identifikimi i problematikave në zbatimin e ligjit aktual që lidhen me hapësira që ligji lë në aspektin interpretativ, implikime që lidhen me mosharmonizimin e ligjit nr. 45/2015 me ligje të tjera që interferojnë në fushën e veprimit të këtij ligji, si dhe me nevojën për shtesa/plotësime për dispozita të caktuara;
- Hartimi i propozimeve paraprahe në rrafshin teknik për ndryshime dhe shtesa;

Në kuadër të këtij procesi, synohet angazhimi i një eksperti ligjor të jashtëm për të garantuar cilësinë juridike dhe përputhshmërinë e propozimeve me standardet e teknikës legjislative dhe që do të punojë ngushtësisht me Grupin e Punës

2 QËLLIMI:

Përgatitja e një drafti të konsoliduar dhe të gatshëm për ndryshime dhe shtesa në ligjin 45/2015, në funksion të adresimit të nevojave të identifikuar dhe të argumentuara nga institucioni nëpërmjet:

- kryerjes të një analize të plotë dhe profesionale të kuadrit aktual ligjor që rregullon veprimtarinë e AIDSSH, me fokus të veçantë Ligjin nr. 45/2015;
- analizimin dhe vlerësimin e kuadrit aktual ligjor në funksion të problematikave konkrete të identifikuar gjatë veprimtarisë së institucionit;
- rishikimin e pavarur profesional të propozimeve të Grupit të Punës dhe vlerësimin e implikimeve të tyre në legjislacionin përkatës;
- riformulimin juridik të propozimeve dhe hartimin e amendamenteve konkrete, duke garantuar koherencën e brendshme dhe harmonizimin me legjislacionin në fuqi;
- përgatitjen e një raporti analitik dhe teknik mbi nevojën për ndërhyrje ligjore, bazuar në informacionin e siguruar nga Grupi i Punës.

3 DETYRAT KRYESORE TË EKSPERTIT:

Eksperti do të kryejë në mënyrë të veçantë:

3.1 Mbledhje të dhënash/informacioni

- Shqyrtimin e raporteve dhe dokumentacionit të përgatitur nga strukturat e Autoritetit;
- Mbledhjen e informacionit të nevojshëm nëpërmjet takimeve me Grupin e Punës;
- Raporte shtesë ad-hoc nga Grupi i Punës;
- Mbledhjen e të dhënave empirike, përmes burimeve ekzistuese: dokumentare, nga interneti, AI, etj.

3.2 Përpunim dhe analizë të dhënash /informacioni

- Analizimin sistematik të informacionit të mbledhur;
- Identifikimin e boshllëqeve ligjore dhe mospërputhjeve;
- Vlerësimin e ndikimit të ndryshimeve të propozuara.

3.3 Konsultime dhe bashkëpunim

- Zhvillimin e takimeve konsultative me grupin e punës;
- Mbledhjen e informacionit shtesë nga strukturat e institucionit;
- Ofrimin e këshillimit juridik gjatë diskutimeve teknike.

3.4 Hartim dhe formulim ligjor

- Përgatitjen e formulimeve juridike të sakta dhe të qarta për çdo ndryshim të propozuar;
- Hartimin e amendamenteve në përputhje me rregullat e teknikës legislative;
- Sigurimin e terminologjisë konsistente në të gjithë tekstin ligjor.

3.5 Harmonizim ligjor

- Verifikimin e përputhshmërisë së propozimeve me:
 - legjislacionin në fuqi që lidhet me veprimtarinë e AIDSSH;
 - parimet e përgjithshme të së drejtës administrative;
- Identifikimin dhe shmangien e konflikteve ligjore.

3.6 Finalizim

- Përgatitjen e draftit përfundimtar të ndryshimeve dhe shtesave në ligj;
- Hartimin e relacionit shpjegues në përputhje me standardet e hartimit të akteve normative.

4 METODOLOGJIA E PUNËS:

Eksperti pritët të përdorë:

- analizë dokumentare;
- konsultime të drejtpërdrejta me grupin e punës;
- standarde të teknikës legislative;
- praktika të mira nga administrata publike dhe, kur është e nevojshme, modele krahasimore.

5 PRODUKTET DHE AFATET:

Eksperti do të dorëzojë:

1. **Raport vlerësimi** mbi kontekstin ligjor aktual dhe domosdoshmërinë e ndërhyrjeve/shtesave në ligjin 45/2015;

brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e dokumentacionit

2. **Draftin paraprak** të ndryshimeve dhe shtesave në ligj;

brenda 30 ditëve kalendarike nga nënshkrimi i kontratës

3. **Relacion shpjegues ligjor**, që përfshin:

- arsyetimin për çdo ndryshim;
- analizën e ndikimit (kur është e aplikueshme);
- përputhshmërinë me legjislacionin ekzistues.

brenda 30 ditëve kalendarike nga nënshkrimi i kontratës

4. **Draftin final të konsoliduar** të ndryshimeve dhe shtesave;

brenda 60 ditëve kalendarike nga nënshkrimi i kontratës.

6 RAPORTIMI DHE MBIKËQYRJA:

Eksperti do të raportojë pranë:

- Sekretarit të Përgjithshëm (si drejtues i grupit të punës);
- ose një strukture të caktuar koordinuese brenda institucionit.

7 KONFIDENCIALITETI:

Eksperti do të nënshkruajë deklaratën e konfidencialitetit dhe është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e të gjithë informacionit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë ushtrimit të detyrës

8 KUSHTET DHE KRITERET E VEÇANTA PËR KANDIDATËT:

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë nivelit të nivelit “Master”, ose me lart, në fushën e Drejtësisë (*Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi*).
- b) Të kenë jo më pak se 5-10 vjet eksperiencë pune në:
 - hartimin e legjislacionit;
 - këshillimin juridik në sektorin public.

- c) Të kenë eksperiencë në teknikat e hartimit të akteve normative;
 - d) Të kenë njohuri të mira të së drejtës administrative;
 - e) Përvojë në projekte të ngjashme përbën avantazh;
 - f) Do të kenë prioritet kandidatët që janë të pajisur me Certifikatë të Sigurimit të Personelit (CSP);
 - g) Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.
- Kandidatët që aplikojnë duhet të plotësojnë gjithashtu kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit 12 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”

9 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT:

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur;
- b- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<https://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime/jeteshkrimi-standard/>
- c- Fotokopje të diplomave (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore (jo më të vjetër se 1 muaj);
- g- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- h- Dëshmi penaliteti;
- i- Vetëdeklarim, ose vërtetim nga institucioni ku ka punuar sëfundmi, që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, referenca apo vlerësimet pozitive për punë të ngjashme të kryera apo punë të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 18.06.2026, në adresën: Zyra e Arkiv-Protokollit, "Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit", Njësia Administrative nr .4, Rruga Kongresi i Manastirit, Garnizoni “Skënderbej” Tiranë.

10 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK:

Jo më vonë se data **18.06.2026**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në faqen zyrtare të AIDSSH dhe në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit për shkaqet e moskualifikimit, (nëpërmjet adresës të e-mail).

11 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi misionin, qëllimin, aktivitetin e deritanishëm të AIDSSH;
- b- Njohuritë, aftësitë, kompetencën ligjore përkatëse për kryerjen e detyrës së kërkuar;
- c- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- d- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

12 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të AIDSSH si dhe portalin “*Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive*”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet përfundimtare të vlerësimit.